

letërsisë gojore — shprehjeve, thëniet, fjalëve të urta, pyetjeve etj. Përmbledhja mbyllet me punimin e Miodrag S. Llalleviqit — *Zagonetka igrarija duha* (Kashelashi lojë argëtuese e shpirtit), ku autori bën fjalë për prejardhjen e emrin e kashelashit, për gjenezën, për formën dhe për

disa karakteristika të tjera si krijim letrar gojor.

Në *Vërejtje* janë dhënë shënimet e burimeve, nga janë marrë studimet dhe artikujt e botuar në këtë përmbledhje.

ANTON BERISHA

Blaže Ristovski, MAKEDONSKI NARODNOOSLOBODITELNI PESNI, Skopje 1974, 80, f. 90. Botim i Institutit të Folklorit Shkup.

Ky botim i veçantë në sendorësi përfaqëson një përmbledhje të shkurtë këngësh maqedone të Luftës Nacionalçlirimtare, këngë, të cilat, në flakën e revolucionit tonë, u mbarështruan, redaktuan dhe botuan prej poetit të shquar maqedon, Koço Racin. Këto këngë ishin shtypur në muajin maj të vitit 1943 në shtypshkronjën ilegale, me të cilën dispononte baza ilegale e Shtabit Kryesor të UNÇ të Maqedonisë në malin Llopushnik. Shkrimtari Koço Racin ishte caktuar nga Shtabi Kryesor dhe nga Komiteti Qendror i PKM redaktor dhe lektor i të gjitha materialeve që shtypeshin prej udhëheqësisë partiake dhe ushtarake të Maqedonisë. Kështu, Koço Racin kishte pregaditur dy përmbledhje të vogla këngësh të LNÇ. Të parën me gjithsej 20 këngë e shtypi sa që vetë gjallë, ndërsa të dytën, vetëm me 11 këngë, ia gjetën shokët në trastë, pasi u vra, dhe e botuan.

Tani Instituti i Folklorit i Shkupit, duke pasur parasysh rëndësinë historike të këtij edicioni këngësh të LNÇ, në të vërtetë të dyja ato përmbledhje i riboton në një ble të vetëm, kështu që kjo përmbledhje ka tash 31 këngë po me atë renditje që ka shtuar revolucionari Koço Racin. Mirëpo, tash përmbledhja është pajisur me një koment mjaft të hollësishëm, në fillim, me melograme e shënime bibliografike për këngët si dhe me një regjistër emrash dhe me rezyme në gjuhën frënge. Tërë këtë punë e ka bërë Dr. Blaže Ristovski.

Komenti, apo më drejt, analiza që i ka bërë Dr. B. Ristovski „Këngëve nacionalçlirimtare maqedone” të Racinit, ka mbështetje shkencore dhe është e bindshme. Së pari ai thotë se edhe këto këngë hyjnë në fondin e këngëve popullore maqedone mbi përpjekjet, kryengritjet dhe luftërat për çlirimin kombëtar të maqedonëve që nga vitet 1877—78 e deri më 1903, kur plasi Kryengritja e Ilindenit. Së dyti, Koço Racini ka qenë njohës i mirë i këngëve dhe i traditës revolucionare maqedone, ka njohur mirë momentin historik dhe në pajtim

me këtë ka bërë zgjedhjen e këngëve me vëmendje, në mënyrë që këto t'i përgjigjen çastit historik dhe aktualitetit të së tashmes.

Përmbledhjet e Koço Racinit kanë rëndësi të dorës së parë për gjuhën maqedone, për historinë e gjuhës, për formimin e gjuhës letrare. Sikundër u tha, Koço Racini ka qenë caktuar prej Komitetit Qendror të PKM jo vetëm si redaktor, por edhe si lektor i fjalës së shkruar dhe të shtypur nga udhëheqësia partiake e ushtarake e Maqedonisë. Me ardhjen e Racinit në bazën e Shtabit Kryesor fillon procesi i krijimit të gjuhës letrare maqedone dhe puna e tij përnjëmend paraqet unifikimin dhe normimin e parë të organizuar të gjuhës maqedone, kurse përmbledhjet përfaqësojnë librin e parë të literaturës së lirë maqedone.

Më pas, autori thotë se në këtë kohë ndër luftëtarët e UNÇ ka mbretëruar një atmosferë ekzaltimi, së këndejmi edhe këto përmbledhje janë një shprehje e gjendjes reale. Në këto këngë me një theks të veçantë potencohet çdo gjë që është maqedone. S'e gjejmë as një këngë, ku të mos zihet ngojë Maqedonia dhe maqedonët. Koço Racin dhe veprat e tij janë revolucionare. Për të s'ka qenë punë e vështirë të hartojë përmbledhje këngësh që do të paraqisnin kontinuitetin e traditës revolucionare, dhe që do të përfaqësonin një shprehje besnike të një faze të re të luftës maqedone për çlirimin kombëtar, dmth. të LNÇ.

S'është gjë e rastit pse Racini nuk i quan popullore këto këngë. Pos ca këngëve popullore, këtu kemi këngë të adaptuara, të autorizuara, këngë masovike, këngë luftarake e marshe, përkthime prej bullgarishtes dhe serbokroatishtes etj. Megjithatë, këto janë shprehje e frymës dhe e ndjenjave të popullit, kështu që populli i ka përqaftuar dhe në saje të kësaj, përmbledhja u bë „publikimi më popullor partizan”.

Sikurse u tha, këtu ka këngë të vjetra mbi luftën për çlirimin kombëtar, të cilat

edhe gjatë Luftës NÇ kanë mundur të jenë aktuale. Mandej vijjnë këngët që u komponuan nga autorë të ndryshëm, ndër të cilët gjindet edhe Koço Racini. Rëndon, këto këngë janë thurë në frymën popullore. Më pas vijjnë këngët e përkthyer, këngët e masave që këndoheshin para luftës etj.

Struktura e këngëve dëshmon se në to janë bërë adaptime e ndryshime, ato janë aktualizuar në pajtim me rethanat e reja, me detyrat dhe qëllimet konkrete të popullit. Racini në mënyrë të shkëlqyeshme e ka kuptuar rëndësinë e traditës poetike të popullit dhe rolin e kësaj tradite në mobilizimin e masave të popullit. Ai ka ditur se këto këngë ka për t'i përqafuar populli,

e kjo do të thotë se ai përqafonte edhe luftën.

Elementi kombëtar i kësaj poezie është komponente e pandarë. Gjihatshu, në këngët nuk mungon as momenti social. Në to zbulojmë një vizion të jetës së ardhshme, pse aty përdoren shprehjet: liria, të drejtat njerëzore, republika popullore, pushteti popullor, demokracia, vëllazërim-bashkimi.

Në këto këngë të Racinit gjuha, leksiku dhe drejtshkrimi nuk kanë lajthitje, pra, përputhen gati krejtësisht me normat e sotme të gjuhës letrare maqedone.

KADRI HALIMI

ETNOGRAFIA SHQIPTARE, Nr. V, Tiranë 1974

Etnografia Shqiptare, Nr. V/74, revistë shkencore e Sektorit të Etnografisë të Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të RP të Shqipërisë, boton në 339 faqe studime dhe materiale të rëndësishme nga lëmi i kulturës shpirtërore dhe materiale të popullit tonë shikuar nga aspekti i shkencës etnografike.

Këtyre punimeve u prin studimi i Rrok Zojziti — *Atlasi etnografik shqiptar dhe problemet e tij*, studim teorik mbi rëndësinë e hartimit të një atlasi të këtillë, mbi punën e deritashme që është bërë në këtë lëmë në vende të tjera dhe mbi metodën e punës për hartimin e atlasit etnografik shqiptar. Etnografët shqiptarë të Sektorit të Etnografisë me ndihmën e shumë bashkëpunëtorëve të jashtëm, i janë përveshur kësaj pune shumë të rëndësishme për kulturën tonë kombëtare dhe deri tash kanë mbledhur dhe sistemuar materiale burimore nga krahinat e ndryshme të Shqipërisë. Në studimin e tij, Rr. Zojzi mbledhjen e materialit të kulturës popullore e shqyrton në mënyrë analitike nga këto aspekte: 1) Materiali etnografik dhe vështirësitë e mbledhjes së tij, 2) Atlasi etnografik dhe procesi historik i zhvillimit të tij, 3) Atlasi etnografik shqiptar dhe kriteret e tij, dhe 4) Metoda e punës praktike për atlasin etnografik shqiptar.

Në Atlasin etnografik shprehet grafikisht, në formë sintetike, sfera e përgjithshme e kulturës popullore duke pajtuar në mes tyre larminë e madhe tematike, transformimet e shumta kohore dhe ndryshimet e shpeshta lokale. Atlasi etnografik është një vepër monumentale në fushën e etnografisë, i cili shpreh në tërësi kulturën popullore, me forma sintetike dhe sipas kërkesave

shkencore. Me ndihmën e tij sqarohen shumë çështje të rëndësishme të historisë sonë si ajo e etnogjenezës, e vendbanimit të hershëm të popullit shqiptar, vazhdimësia kulturore, ndikimi reciprok në mes të tij e popujve të tjerë, formimi kombëtar i popullit tonë etj. Njëkohësisht në të pasqyrohet qartë procesi historik i zhvillimit të popullit që nga kohët e lashta deri në ditët tona, pastaj dhe niveli i zhvillimit të kulturës popullore, anët e mira e të dobëta të saj dhe pësha specifike e tyre. Atlasi etnografik na jep bazën e punës për zhvillimin e mëtejshëm të traditave tona kulturore.

Punimi i Rr. Zojziti mbi Atlasin etnografik shqiptar është një kontribut i mirë i këtij shkencëtari të njohur që puna e madhe në përpilimin e kësaj vepre monumentale të vihet në baza të shëndosh a shkencore, të zhvillohet sipas metodës më të përshtatshme dhe të kurorëzohet me sukses.

Mark Tirtja në studimin e tij *Elemente të kulteve ilire të shqiptarët (kulti i diellit)* rrah një problem shumë interesant nga kultura shpirtërore me një origjinë shumë të lashtë, por me një vazhdimësi të pandërprerë që nga ilirët deri në ditët tona. Në bazë të një literature të pasur shkencore, të dhënave folklorike dhe të materialit burimor, autori ka dhënë një kontribut të vlefshëm shkencor mbi kultin e diellit që është shumë i përhapur kudo në botë, e gjithashtu edhe ndër ne. Ky kult shprehet sidomos në ornamentikën popullore, por edhe në folklor dhe në besime të ndryshme në lidhje me diellin, madje edhe në toponomastikën e viseve të ndryshme. Autori përfundon me plot të drejtë se — prania e